

JONUZ DINI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-2

852

KOMEDI


SHERBETORI

SH-2
652

JONUZ DINI

SHERBËTORI

komedi



1938

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

10000 DINA

SHERBËTORI

komedi

Tirazhi 1000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash:2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
TIRANË, 1976

PERSONAZHET :

- DOM ZEFI — famulltar i një fshati buzë liqenit të Shkodrës, dyzet e pesë vjeç.
- GJONI — xhaxhai i tij, rreth të gjashtëdhjetave.
- NDREKA — i vëllai, tridhjetë e pesë vjeç.
- AGETINA — mikeshja e dom Zefit, njëzetedyvjeçare.
- LAJDJA — mikeshja e Gjonit, rreth të tridhjetave.
- NUSHA — shërbëtore e dom Zefit, afër dyzet vjeç.
- TEFA — shërbëtori
- SIMONI — kryeplaku i fshatit
- PJETRI — anëtar i kryepleqësisë
- LUCA — berberi i fshatit.
- GALOTI — major i SIM-it
- LORO — shërbëtor i Gjonit dhe karrocier.
- MULLA ALUSHI — hoxha
- MURGESHA
- OFICERI
- POLICË E KARABINIERË.

PJESA E PARË

Një dhomë e madhe, e pajisur me mobilje të vjetra. Ndër mure janë varur tri fotografi: Duçja, papa dhe mbreti shkurtabiq, Viktor Emanueli. Përballë, në një vend të dukshëm, është Krishti i gozhduar mbi një kryq prej metali.

Nga dy dritaret e hapura shihet sipërfaqja e liqenit që farfurin. Diku larg jehon një këngë që sa vjen e afrohet.

Bri një tryeze të vogël, nën Krishtin e gozhduar, është ulur prifti, i zoti i shtëpisë. Diçka shkruan. Kur kënga afrohet shumë, ai ngrihet me hov dhe mbyll kanatet e dritares që ka afër.

DOM ZEFI — Mallëkuar qofshi! S'të lini as të bësh hesape! (*Ulet prapë ku ishte. Befas thërret i gëzuar.*) E gjeta, e gjeta! Ja ku e kam bërë gabimin: 7 edhe 8, nuk bëjnë 13, po 15. (*Ngrihet merr frymë i lehtësuar.*) Tridhjetë napolona më pak fitim, një fjalë goje! (*Sillet një grimë i menduar.*) Hajde, xhaxha, s'duhet të zemërohesh, se në xhepin e nipit tënd po hyjnë... (*Kujtohet për diçka*) Oh, po unë kam ftuar miq, si më dolën nga mendja? Napolonat më hutuan, e marrtë e mira!

NUSHA — (*Hyn, është veshur me një fustan të thjeshtë e një përparse të bardhë.*) Më thirrët, zotëri?

DOM ZEFI — Hajt, shpejto, rregullo dhomën. Sonte kemi festë! Mos harro se na vijnë miq. A nuk të thashë?

NUSHA — I kam bërë të gjitha gati, zotëri, vetëm kjo dhomë më ka mbetur pa u rregulluar.

(Duket Simoni në prag. Përshëndet dhe buzëqesh.)

SIMONI — Ma gëzofsh festën, dom Zef.

DOM ZEFI — Gëzuar qofsh, Simon. Por... më duket... se ke ardhur herët.

SIMONI — Nuk erdha për të ndenjtur, por thashë, po vete të shikoj se mos ka ndonjë nevojë famulltari ynë i nderuar.

NUSHA — Bëre shumë mirë që erdhe, se ja, për shembull, atë tryezën e madhe të bukës nuk jam e zonja ta luaj nga vendi e më vjen turp t'i them dom Zefit.

SIMONI — Jam gati t'i vë shpatullat punës, moj Nushë.

DOM ZEFI — Shumë mirë! *(Dalin nga një derë anësore, pas pak kthehen duke bartur tryezën.)* Po të ma kishe dërguar shërbëtorin tani s'do ta mbaja tryezën në krahë.

SIMONI — Zotëri, nuk vijnë... Thonë... thonë...
(Nusha merret me rregullimin e tryezës.)

DOM ZEFI — Çfarë thonë?

SIMONI — Jo... jo... Më vraftë ai Krisht, që është atje në mur. Fundja unë s'po shpif gjë. Thonë se rroga është e vogël e s'u leverdis... Ju jap fjalën son-te, se do të flas me një mikun tim në Mirditë. Mirditorët, dom Zef, janë njerëz të varfër, të shtruar e besnikë ashtu si i do zotrote.

DOM ZEFI — Kam folur edhe unë me një farë Bibë Ndou, kryeplak i fshatit Urith. E njeh? Më ka dhënë fjalën, por... edhe ai e zgjati si shumë.

SIMONI — Mos u bëj merak, do ta marr vetë në dorë

këtë punë e, pa u mbushur java, shërbëtorin do ta kesh këtu.

NUSHA — Simon, më ndihmo pak ta largojmë këtë raft.

SIMONI — Eh, Nushë, të qepesh si ferrë...

DOM ZEFI — The se erdhe të na ndihmosh apo jo?

SIMONI — Ta dija, merrja me vete Pjetrin, zotëri, ai është shulak...

NUSHA — Hë de, kape!

SIMONI — Kjo edhe të urdhëron, hëm! (*E ndihmon.*)
Ke gjë tjetër?

NUSHA — Prit, mund të kem.

SIMONI — Unë për vete punova mjaft, tani po dal se kam disa porosi.

DOM ZEFI — Prit! Po e gjete Lucën dërgoje këtu se mbeta pa rruar.

(Simoni del. Dom Zefi këndon nën buzë një këngë italiane. Hyn Luca me një legen berberësh e me një peshqir. Është i shkathët dhe natyrë gazmore.)

DOM ZEFI — Lucë, pse u vonove sot?

LUCA — Më dolën disa myshterinj rrugës.

DOM ZEFI — Lëri ato. (*Nushës.*) Nushë, na sill pak ujë të nxehtë.

NUSHA — Ja tani, sa të ndez zjarrin.

LUCA — Ec më mirë mbush një sapllak në liqen se e ka shumë të ngrohtë.

DOM ZEFI — Mos u vono, Nushë. (*Nusha del.*) Ah, ç'po vuaj unë i shkreti, more Lucë... Gjysmat e punëve më duhet t'i bëj vetë se nuk po gjej dot një shërbëtor. Të gjithë më gënjejnë, edhe Simoni, edhe Pjetri, edhe Bibë Ndou.

LUCA — Pse s'më ke thënë mua, dom Zef...

DOM ZEFI — A ma gjen shpejt?

LUCA — Menjëherë. Vij vetë, po më pagove mirë.

- DOM ZEFI — Ik, o dreq. (*Pendohet dhe fillon të lutet.*)
Domine misericordum.
- LUCA — A e more vesh ç'ka ngjarë, dom Zef? Një ushtar shqiptar ka dezertuar duke marrë me vete dhe një qerre armë.
- DOM ZEFI — Ç'po thua, more?
- LUCA — Atë që dëgjova, pra. Dhe një oficer italian u gjend i vrarë.
- DOM ZEFI — Këtu kanë gisht komunistët.
- LUCA — A thua?
- DOM ZEFI — Me siguri. (*Hyn Nusha me një sapllak ujë.*) Hajde, luaj duart! Ç'më prishe humorin...
- LUCA — (*Nis ta rruajë*) Të djeg?
- DOM ZEFI — Pak.
- LUCA — Si shumë përgatitje po shoh sonte. Mos është festë?
- DOM ZEFI — Do të presim disa mysafirë.
- LUCA — Po peshk a keni gatuar, moj Nushë?
- NUSHA — A të ra erë, a?
- LUCA — Edhe po të mos më bjerë erë, e di prej kohësh se dom Zefi e ndjek shumë peshkun. A po jo, dom Zef?
- DOM ZEFI — (*I cili e kupton nëntekstin*) Peshkun edhe i lumi zot e ka bekuar.
- LUCA — Po për peshkatarët ka thënë gjë zoti?
- DOM ZEFI — A po i shpejton pak duart!
- LUCA — Ti merr përsëri dhjetë për qind nga sinjori Piaceli, apo jo? Në njëqind dhjetë, në një mijë njëqind, në njëqind mijë, dhjetë mijë, hë?...
- (*Hyn Simoni dhe pas tij edhe Pjetri.*)
- SIMONI — Nuk keni mbaruar punë?
- DOM ZEFI — Ka llafe shumë ky. Lodhet duke bërë hesapet e botës.
- PJETRI — Mirëmbërëma, zotëri!

- DOM ZEFI-- E mira të ndjektiv pas ngado që të shkosh,
Pjetër!
- LUCA — *(I heq peshqirin nga qafa.)* Mbarova.
- SIMONI — Me shëndet!
- PJETRI — Me shëndet, zotëri!
- DOM ZEFI — Ju lumtë goja. Pak kolonjë, more ti.
- LUCA — Harrova... *(I hedh.)*
- DOM ZEFI — Ti nuk më the: «Të dalshin me shëndet!»,
o i bekuar!
- LUCA — E thashë me mend.
- DOM ZEFI — Si mund të sigurohem për këtë?
- LUCA — Nga qimet që do t'ju dalin. Po u sëmurët jam
gati t'ju rruaj falas.
- DOM ZEFI — *(Hap gojën t'i thotë diçka, po si duket
pendohet, prandaj buzëqesh e luan kokën sikur e
qorton për diçka që e dinë vetëm ata të dy. Bën
të dalë nga dera anësore. Dëgjohet zhurma e një
karroce që ndalon në oborr dhe një zë: «Hyyyj»)*
- ZËRI I GJONIT — *(Nga jashtë)* O dom Zef, dilni e më
jepni dorën se nuk i ngjit dot këto drejt shkallësh!
- LUCA — Ih, ih, ih, kush erdhi!
- ZËRI I GJONIT — Loro, Loro, hej shurdho! Merr ka-
loshinën e mbathja. Shko fluturim e më sill zonjën
Lajde.
- ZËRI I LOROS — Peqe, zotëri. Yjo, Kuqo! *(Dëgjohet
zhurma e kaloshinës që largohet)*
- ZËRI I GJONIT — Ju janë zënë veshët, a? Dilni, bre!
- SIMONI — Prisni, zoti Gjon.
- PJETRI — Erdhëm.
- SIMONI — Dil, Pjetër.
- PJETRI — Pa ty, nuk e luaj këmbën. Nuk jam i zoti ta
mbaj vetëm atë elefant.
- SIMONI — Merr Lucën.
- LUCA — Nuk ngre pesha të rënda.

SIMONI — *(Me inat)* Mirë, shkojmë ne. *(Dalin)*

NUSHA — Na erdhi belaja te dera...

LUCA — Ka ardhur që më 7 prill, Nushë.

NUSHA — Them për këtë që po ngjit shkallët.

(Hyn Gjoni e ngre dorën përjetë.)

GJONI — Eviva¹⁾, zotëri, eviva! Pse nuk salutoni, hej ju marrtë dreqi? *(Simonit dhe Pjetrit)* Eviva, ju!

SIMONI — Eviva, eviva, eviva, tri herë.

PJETRI — Një mijë herë.

SIMONI — Po të jetë ashtu, një milion.

PJETRI — Duçe, Duçe!

GJONI — Edhe ai Loroja im më duket se është bolshhevik, i kuq, ai kryekungull! Thotë: «Po të ishte fashizmi i mirë, zotëri, italianët nuk do ta kishin lënë të vinte këtu, po do ta mbanin të gjithë për vete. «Ke parë ti, Loroja! Pastaj nis llogorit rrufjani: «Mirë Duçja thotë: «Shqipërinë e kam në zemër», po kush na siguron se një ditë, kur të jetë i uritur, nuk e përcjell drejt në stomak?» Loroja! Kushedi si e mendon zemrën ajo kafshë me dy këmbë. Uluni! Uluni! *(Ulet edhe vetë.)* Ufff! Shkallë të këqija! Kërcasin kërr-kërr, sikur po bëjnë një punë të madhe. Ju hëngërt dreqi farën! Ndreçini të shkretat! Nuk jeni të zotët për asgjë, veç të llapni dhe të llupni.

SIMONI — E di si është puna, zoti Gjon...

PJETRI — Edhe prej guri të ishin zotëri, do të bënin kërr-kërr të gjorat duke mbartur në kurriz një...

GJONI — Një?

SIMONI — Një div, domethënë.

PJETRI — Jo, desha të them një...

1) eviva — rroftë.

GJONI — Mjaft! Unë një, ju njëqind! Ti, more shurdh!
Lucë, i ke veglat me vete? Po? Mirë. Më rruaj.

LUCA — Veç jashtë dyqanit kushton më shtrenjtë!

GJONI — Po ti nuk erdhe këtu kastile për mua? Ti erdhe për tjetër kënd. Unë të gjeta...

LUCA — Mirë, unë po dal e po kthehem kastile për ju, ose e lëmë për nesër.

GJONI — Jo, jo, nuk pret puna. Eja fillo. (*Luca afrohet e nis t'i zbutë mjekrën.*) E, ju të tjerët, merrni ndonjë këngë.

SIMONI — Këngë shkodrane?

GJONI — Italiane, italiane. Ndonjë të re!

SIMONI — Ato i qan Pjetri. Hajde, Pjetër, jepi!

PJETRI — Duhet njomur goja, pa pastaj...

GJONI — Ahu, ti paske fjalë shumë!

PJETRI — (*Këndon*) E arrivato l'ambasciatore
kon la piuma sul kapelo.¹⁾

SIMONI — Kjo nuk është ajo që pëlqen zoti Gjon.

GJONI — A e morët vesh ç'kishte ngjarë? Një oficer italian u gjend i vvarë.

PJETRI — (*I hutuar.*) Mos more! (*Befas*) Po kush vallë?

GJONI — S'dihet. Enigmë.

(*Vjen dom Zefi.*)

DOM ZEFI — Mirë se erdhe, xhaxha! (*I jep dorën.*)

GJONI — Kjo punë do të na hapë ngatërresa. S'i thonë shaka të vritet një oficer. E more vesh besoj?

DOM ZEFI — Po, ma tha Luca.

GJONI — Të paktën a e rregullove atë punën e kontratës apo edhe këtë herë mbetëm me gisht në gojë?

DOM ZEFI — Jo mbetëm, mbete xhaxha. Na lini pak vetëm, ju lutem. (*Dalin Pjetri, Simoni dhe Luca.*)

1) Arriti ambasadori me pendën në kapelë.

- GJONI — Bukur ma ke luajtur bërrylin mua, xhaxhait.
Nip i poshtër. Kontrata është jotja. E di mirë. Fol,
sa do?
- DOM ZEFI — Pjesën time unë nuk e shisja, veç më pengon veladoni të merrem me tregti. Është punë me leverdi të madhe. Paratë gurgullojnë aty si ujët e bollshëm. Ç'e do se kam veladonin...
- GJONI — Ah, ta kisha edhe unë një mbulesë të atillë, do ta vërtisja edhe më me lehtësi tregtinë. Po lëre tani. Sa?
- DOM ZEFI — Një mijë napolona.
- GJONI — Obobo, ç'po më dëgjojnë veshët! Pesëqind.
- DOM ZEFI — Asnjë qindarkë më pak.
- GJONI — Ma jep kontratën ta shoh. (*Prihti ia jep. Ai e vështron dhe bën llogari.*) Ah, shiko... Po mirë. (*Fut kontratën në xhep.*) Në rregull.
- DOM ZEFI — Xhaxha, nuk e ka vendin aty.
- GJONI — Dua garanci unë, s'të zë bes ty.
- DOM ZEFI — Për çfarë?
- GJONI — Për napolonat.
- DOM ZEFI — Ku janë, nuk po i shoh.
- GJONI — T'i jap nesër.
- DOM ZEFI — Edhe unë garancinë ta jap nesër. Ma jep kontratën!
- GJONI — Nuk i beson xhaxhait ti?!
- DOM ZEFI — Tregtia nuk ka besë, ti e ke thënë vetë. Ma jep. (*Me një lëvizje të shpejtë ia heq nga xhepi.*)
- GJONI — Dreqi vetë je, nipçe. Mirë, do ta rregullojmë. (*Dëgjohen rrotat e karrocës dhe zëri i Loros: «Yyyj! Hop karroca!»*)
- GJONI — Erdhi zonja Lajde.
- DOM ZEFI — Nuk e kam ftuar.
- GJONI — E kam ftuar unë.

- LAJDJA — *(Nga jashtë.)* More Gjon, Xho-va-ni!
- GJONI — Këtu jam shpirt, këtu. *(Fshin fytyrën.)* Uf, vapë!
- LAJDJA — Oh, ç'errësirë, Xhovani!
- GJONI — Dilni ju, Simon, Pjetër! Merrni një kandil dhe dilni e priteni.
- LAJDJA — Agetinë, shpirt, këtej. Më jep dorën.
- DOM ZEFI — *(Brof në këmbë)* E? Agetina? *(Afrohet te dritarja dhe vëren jashtë.)* Agetinë, ti je?
- AGETINA — *(Nga jashtë)* Unë, dom Zef.
- DOM ZEFI — *(Merr kandilin.)* Erdha. *(Del.)*
- GJONI — E ju ç'rrini ashtu si hunj gardhi! Diluni përpara damave, ju hëngërt dreqi, ju hëngërt! *(Simoni edhe Pjetri dalin.)* Ladi, Ladi!
- LAJDJA — *(Hyn në majë të gishtave dhe i zë sytë me pëllëmbë.)* Kuku!
- GJONI — *(Ia kap dorën dhe ia puth.)* Ëmbëlsira ime!
- LAJDJA — Ah, ç'natë e bukur sonte! Liqeni farfurin si serm i shkrirë, Xhovani. Farfurin si ser i shkrirë, mirë e thashë? Dalim shëtisim bregut...
- GJONI — Nuk jam i zoti për atë shëtitje. Nuk e sheh? Unë jam 121 kilogram.
- LAJDJA — Mos ha shumë, Xhovani.
- GJONI — Një fjalë goje. Të vdes nga uria? Mirë. Po të më thuash ti: «Vdis!», vdes unë.
- LAJDJA — Uh, kalama që bëhesh. *(E puth në ballë.)* Pa ty jeta do të më dukej natë... Ah, shiko, shiko, një varkë përmbi liqen! Oh, po së paku të gjejmë një varkë.
- GJONI — Nesër, nesër.
- LAJDJA — Do të kërcej në ujë: bulldum, ah!
- GJONI — Ruhë, ruhu, se liqeni është shumë i pabesë. Për çdo vit ha dy-tre njerëz, tamam si ajo kuçë-dra e përrallës.

- (*Hyn Agetina pas saj dom Zefi, Simoni e Pjetri.*)
- AGETINA — (*Mbaron bisedën që ka filluar jashtë*)... më mori zonja Lajde. Oh, ç'hoqa për t'i ikur atij vëllait tënd, Ndrekës! Mezi më la të hipja në kaloshinë. Zonja Lajde i foli, po ku merrte vesh ai. Pastaj na u vu prapa me biçikletë duke thirrur: «Amore! Do të vij pas jush, nuk ju lë vetëm...»
- DOM ZEFI — Idioti !
- AGETINA — Dësh zoti e Loroja e ngau kalin dhe e lamë pas, se atij nuk i bëhej vonë për njerëzit që ndaleshin dhe e shikonin të habitur. Edhe nja dy a tri herë ka bërë marrëzira të tilla, por unë nuk t'i kam thënë.
- DOM ZEFI — Do t'i flas sonte kur të vijë, ndoshta topitet sadopak. (*Serioz.*) Pse erdhe, Agetinë? Unë të thashë, mos u duk më këtu...
- AGETINA — (*Si ai.*) Edhe më këmbë do të vija sonte... (*Qan.*)
- DOM ZEFI — Mos qaj, marroçkë. Mirë se erdhe! (*Nën zë.*) Fol, Agetinë, ç'ke, moj zoga ime?
- AGETINA — Pse, nuk të vete mendja ty?
- DOM ZEFI — Jo, për Krisht...
- AGETINA — Oh, e mjera unë! Jam... Jo, nuk mund ta them. Nuk e merr me mend ti vetë?
- DOM ZEFI — (*Agetinës, i trembur.*) Nuk është e mundur...
- AGETINA — (*Çohet dhe e kap për veladoni.*) Mos u tall me pafajësinë time, Zef. Unë duhet të martohem...
- DOM ZEFI — Mos thirr! (*I trullosur.*) Me mua? Po unë jam prift... Oh, ç'dhuratë të bukur më solle për ditën e emrit!
- AGETINA — Mendo ç'të bëjmë. (*Dom Zefi fut fytyrën ndër pëllëmbë po menjëherë kujtohet se aty*)

ka edhe njerëz të tjerë. Përpiqet të marrë një farë pamjeje të qetë për të fshehur këtë goditje.)

GJONI — Lajde, a po ma thërret këtu Lucën, se më la si gjysmagjel?

LAJDJA — Ja tani. Luca, berber i Seviljes!

LUCA — Gati, këtu po pres. *(Hyn dhe fillon ta rruajë.)*

LAJDJA — *(Ulet diku afër.)* E ke marrë gramafonin? Duhet pak muzikë. Ah, unë e mjera, sa e ndijshme që jam.

DOM ZEFI — *(Agetinës lehtas.)* Duhet gjetur patjetër një rrugëdalje... Unë po vdes nga dëshpërimi... Duhet një paravent... *(Sillet nëpër dhomë i menduar me duart e kryqëzuara në gjoks. Belbëzon. Agetina e ndjek me bisht të syrit. Ndalet befas. Nën zë.)* Ndreka, im vëlla, Agetinë... E di, nuk do të ishte keq...

AGETINA — Ai është mendje lehtë... Idiot, si e the ti.

DOM ZEFI — Ç'të duhet mendja e tij? Është rasti më i mirë. Ai bëhet me grua, ti me burrë dhe unë me kunatë. Hë, fol?

AGETINA — S'di si të them. Po s'ka lezet të martohem kot...

DOM ZEFI — Pse kot? Ndreka është i pashëm dhe hiret nuk i mungojnë... Hë, si thua?

AGETINA — Po ti si po ia bën këtë gjë vëllait?

DOM ZEFI — Unë po i bëj një të mirë... Si thua, apo ke ndonjë zgjidhje tjetër?

AGETINA — Unë, jo.

DOM ZEFI — Atëherë kështu, veç s'di a do t'ia mbushim mendjen shpejt.

LAJDJA — Shih, shih, madona mia! Xhuzepe, Leonardo, çau!

GJONI — Mos thirr aq, se të sëmuren bajamet.

LAJDJA — Salute Xhuzepe! Ah, sa inat, nuk dëgjon.

LUCA — Me shëndet! (*I shtrin dorën*)

GJONI — Shëndet paç! (*I jep dorën si për ta tokur.*)

LUCA — Shëndeti pa para, është sëmundja më e keqe.

LAJDJA — Leonardo! Ej, Xhuzepe, Xhuzepe! Ah, djem të ëmbël! Ah, ja, ja, më panë. Çau, çau, sono io.¹⁾ Xhuzepe, salute! (*Dëgjohet një zë: «Buona sera, sinjora!».* Pas tij edhe një tjetër: «Salute sinjora, çau!»)

Uf, edhe ti, je xheloz tamam si Otello! Ja ç'je ti. Pikën e delikatesës s'e ke! Rri! Më ngrë nervat tani. Çau Xhuzepe.

(*Hyn mulla Alushi duke përshëndetur allafashiste.*)

MULLA ALUSHI — Mirëmbrema, e mirë qofshi në këtë shtëpi gjithmonë (*Lajdja, kur e sheh, ia jep gazet. Pak më të përmbajtur qeshin edhe të tjerët. Hoxha vëren për qark dhe qesh edhe vetë. Në fund, pasi i bie mjekrës me pëllëmbë, kollet, sikur do të thotë: «Mjaft del!» — (Me ton të butë) Për shumë vjet dom Zef, e gëzofsh, me shëndet e paç gjithmonë bekimin e zotit mbi kokë! (I shtrëngon dorën.) Fala jacinë e thashë: «Po shkoj te dom Zefi që të rri pak e ta uroj, se jemi edhe komshinj». Si je, zoti Gjon? Të paçim! Ju, zonja, si jeni? Mashaallah! Unë jam imami i lagjes myslimane këtu.*

LUCA — Po mua pse s'më flet, hoxhë efendi?

MULLA ALUSHI — Me berberët s'kam punë.

LUCA — Një gërshërë të lehtë? (*Hoxha mohon.*) Si të duash. (*Del.*)

DOM ZEFI — Ulu, mulla Alush, mos rri në këmbë.

MULLA ALUSHI — Po, si urdhëron, po ulem. (*Ulet.*)

Katundi është mbushur me ushtarë. I përshëndeta

1) jam unë.

kështu me dorë përpjetë e ata bënë buzën në gaz e më liruan rrugë. Sa të mirë janë! Pije nuk dua.

DOM ZEFI — Të bëjmë kafe?

MULLA ALUSHI — Jo, mos u mërzitni. Nuk po ndahem nga shokët, si thonë. Meze paske mjaft e po bub-
rojoj diçka. (*Fut duart në pjatë.*)

GJONI — Jo me shkopinj mishi, mulla Alush. Ja pi-
runin!

LAJDJA — (*Qesh.*) Shkopinj mishi! Bukur e the, Xho-
vani.

GJONI — Shpirt!

MULLA ALUSHI — Keni një të mirë ju, katolikët, se i
doni shumë gratë.

GJONI — Edhe ju po të mos i donit nuk do të merrnit
nga dy-tri gra. Sa lejon sherihati?

MULLA ALUSHI — Gjer në shtatë, më shumë jo. Kur
më thoshte dom Zefi: «Do të vijë Italia, mulla
Alush, e do të mbarojnë hallet tona,» unë, për qime
të Pejamberit, kisha një farë dyshimi, se thosha me
mend janë kaurë, kurse tani jo. (*Ndërsa flet edhe
ha.*)

GJONI — Nuk ke ngrënë darkë, mulla Alush?

MULLA ALUSHI — Hëngra, po nuk më lezetoi.

LAJDJA — Sa i këndshëm që duket me atë mjekër!


GJONI — Lajde, kujdes mos tradhto fenë.

LAJDJA — Ah, ku të vete mendja!

(*Hyn Ndreka.*)

NDREKA — Mirëmbërma! (*Dom Zefit.*) Ma gëzofsh em-
rin, vëlla!

DOM ZEFI — (*E përqafton.*) Te ti e kisha mendjen. Ai
që duhet të ishte i pari këtu, thashë, po vonohet e
ndoshta nuk po vjen fare. (*E merr mënjanë.*) Pas-
taj nuk të kam thirrur kot sonte, Ndrekë. Kam men-
duar diçka të mirë për ty. E shikon atë vajzën aty?



Hë, është Agetina, e bija e Nikë Palokës. Familje e ndershme. Sa e kam parë, më ka shkuar mendja te ti. «Ja një nuse për Ndreken», thashë. E solli zonja Lajde këtu sonte. Shikoje, shikoje, e rriji afër. Dhe, po të të pëlqejë...

NDREKA — Oh, u dogja për të si digjet toka për shi, vëlla! Oh, (*E përqafton,*) të paça përjetë!

GJONI — Ç'po flisni ashtu vesh më vesh? Ec toke edhe me mua, nipçe. (*Ndreka afrohet e u jep dorën të gjithëve me radhë. Agetinës në fund. Ulet afër saj.*)

NDREKA — Pse largoheni kështu, bukuroshe.

AGETINA — Më vjen turp...

NDREKA — (*Disi i turpëruar.*) Edhe mua. Po do të mësohemi duke ndenjtur pranë njëri-tjetrit.

LAJDJA — A lozim «Moska çeka?» (*Ngrihet.*) Është lojë italiane, shumë e bukur, sidomos për dashnorët. Domethënë miza qorre, shqip. E kam luajtur te Çotarët për herë të parë. Kishte mjaft të rinj atë natë. Oh, sa qejf! Medet! Sonte këtu...

LOROJA — Edhe këtu ka, zonjë

LAJDJA — Agetinë, çohu!

Rri ti! E dini, është si ajo loja e fëmijëve: «Sillu, sillu rrumbullak — me një tufë lule — bëjmë byyy!» Diçka kështu. Hë, ma jep dorën. Edhe ti, dom Zef. Hoxhë, ec këtu!

MULLA ALUSHI — Nuk ma lejon kurani, zonjë. Unë do të rri këtu.

GJONI — Si punë arbitri.

LOROJA — A ka ndonjë dobi kjo punë, zonjë?

LAJDJA — Po, Loro, po. Ne do të sillemi rreth. Ti në mes. (*Ia lidh sytë.*) Kështu. He! Ne do të sillemi... Ka edhe ca fjalë të tjera po nuk i mbaj mend. Ne jse, ne po këndojmë!

GJONI — Mos u lodhni hiç, se po vë gramafonin. Loro!

LOROJA — Kam detyra të tjera tani. Nuk e shihni?

LAJDJA — Vëre vetë ti, Xhovani, nuk është punë e rëndë.

LOROJA — Nuk më the ç'fitim kam unë nga kjo lojë, zonjë?

LAJDJA — Ah, po! Ne sillemi. Atë që do të kapësh do ta dënojmë me diçka... (*Zoti Gjon shkon te gramafoni.*) *Hyn murgësja*)

MURGESHA — Jeee!

(*Gjoni ka vënë pllakën dhe dëgjohet muzikë.*)

LAJDJA — Fillojmë. (*Sillen. Loroja i sulet Lajdes.*)

LOROJA — Të kapa.

GJONI — (*Heq pllakën.*) Ej, ç'po bën ti more?

LOROJA — Kështu është loja. (*Qeshin.*)

GJONI — Mos, mor judë!

LOROJA — Kjo është lojë, zotëri, pse e prish gjakun?

GJONI — Kjo qenka lojë e poshtër. (*Lajdes.*) Po ti, moj?

LAJDJA — Oh Xhovani, s'e kupton humorin evropian.

GJONI — Çfarë humori, të kapesh në sy të burrave?

LOROJA — Unë them të luajmë edhe një herë. (*Troket dera.*)

GALOTI — Buona sera, sinjori!

LAJDJA — Oh, finalmente erdhi një! Buona sera, sinjore! (I jep dorën.)

GJONI — Lajde!

LAJDJA — Otello!

DOM ZEFI — Keni bërë shumë mirë, sinjor Galoti. Urdhëroni.

MULLA ALUSHI — (*Çon dorën përpjetë.*) Salve!

GALOTI — (*E shikon dhe tund dorën.*) Salve! (*Dom Zefit.*) Nuk do të rri. Paskeni festë.

DOM ZEFI — Ditën e emrit. Ju ftova të vinit. (*I jep një gotë pije.*) Më uroni, sinjor Galoti.

GALOTI — Ah, po, më kujtohet... më thatë... Punë...
Jemi trullorur fare. Po na nxjerrin telashe ca...
Auguri, sinjor abate! (*Pi. Pastaj e merr mënjanë.*)
Rrethuan fshatin, se kishim informata që këtu,
madje në shtëpinë e Ndoc Gushës, anëtarit të krye-
pleqësisë qenka fshehur një ushtar shqiptar që ka
vrrarë te ura e Bahçallëkut oficerin italian.

DOM ZEFI — E kapët?

GALOTI — Nuk e gjetëm.

DOM ZEFI — Ai Ndoci është lugat ferri. Merreni me
vete atë dhe, nxirriani ku e ka fshehur, sinjor Ga-
loti. Ai është i zoti të bëjë gjithçka.

GALOTI — Ashtu do të bëjmë. Po ju, sinjor abate, ki-
ni parasysh të hetoni ku ndodhet ai... ushtari. Ësh-
të detyra juaj. Thuaja edhe hoxhës.

DOM ZEFI — Si urdhëron, do t'i vë në lëvizje të gjithë.

GALOTI — (*Të gjithëve.*) Më falni! Buona note! (*Ni-
set. Dom Zefi e shoqëron.*)

LAJDJA — Agetinë, ti, murgeshë, dalim shëtisim pak
bregut të liqenit se po ngordh nga mërzia.

MURGESHA — Jee! Tani natën?

AGETINA — Kam frikë.

NDREKA — Vij edhe unë. (*Agetinës lehtë.*) Mollë e
kuqe, topsheqere...

AGETINA — (*Bën buzën në gaz.*) Ah, meqë vjen edhe
Ndreka, shkojmë.

LAJDJA — Dalim.

GJONI— Loro, luaj, më ndihmo të ngrihem.

(*Kthehet dom Zefi.*)

DOM ZEFI — Po ju, ç'jeni ngritur të gjithë?

MULLA ALUSHI — Duan të gjesdisin bregut të liqenit.

DOM ZEFI — Kthehuni, zotërinj. Hamë bukë, pastaj
dalim.

GJONI — Tamam, shëtitja bëhet pas darke.

(*Hyn Luca bashkë me një fshatar.*)

LUCA — Dom Zef u ktheva përsëri unë. Të solla një peshqesh për ditën e emrit që do të të gëzojë.

GJONI — Ëëë, sa shumë llap edhe ky. He, more, bjeri shkurt. Ç'është ai peshqesh?

DOM ZEFI — Nuk pres peshqesh prej teje, Lucë.

LUCA — E megjithatë, ja! (*Tregon fshatarin.*)

GJONI — (*Qesh.*) Ky është hokatar, djalli...

LUCA — Nuk po kujtohesh, zotëri? Shërbëtori, de, shërbëtori. Ta dërgon peshqesh Bibë Ndou, kryeplaku i fshatit Urith.

DOM ZEFI — Po, po. Hëm. Pjetri me Simonin më kanë mbushur me rrena, ndërsa ai, pa u mbushur muaji, ja... Po gëzohem vërtet. Si je djalosh?

SHËRBËTORI — Mirë, zotëri.

DOM ZEFI — (*Vështron Lucën.*) Po ty ç'të lidh me këtë punë?

LUCA — Asgjë. E takova në rrugë. Më pyeti nëse e dija shtëpinë e dom Zefit dhe unë i thashë oh, posi, ai është miku im. Eja se po të shpie vetë.

LAJDJA — Sa i lezetshëm, hë?

LUCA — Dhe kështu e solla. Nuk do ta mbash, a?

DOM ZEFI — E prisja pak më të vogël. Bibë Ndou më tha se po më dërgonte një djalë 13-14 vjeçar. Kurse ky...

LUCA — Ky ka qenë 13-14 vjeç para disa vjetësh. Asgjë nuk prish.

DOM ZEFI — Sa vjeç je, biri im?

SHËRBËTORI — Njëzet e dy.

DOM ZEFI — E ke kryer ushtrinë?

SHËRBËTORI — Po.

LAJDJA — U, edhe ti, dom Zef, tërë këto pyetje. Sikur jemi në kuesturë. Ec, djalosh, e ulu këtu. (*Tefa nuk lëviz.*)

LUCA — (*Merr gotën.*) Dom Zef, për të mirë e në gëzime gjithmonë!

GJONI — Lajde!

LAJDJA — Rri ti! (*Vëren Tefën.*) Po të vishesh me rroba qytetare oh, sa i bukur do të dukesh! Xhovanë, merre ti këtë shërbëtor, se dom Zefi po i bën naze.

GJONI — (*Xheloz.*) Jo!

LAJDJA — (*E prekur.*) E marr unë më mirë!

DOM ZEFI — Më vjen keq që nuk mund t'jua plotësoj dëshirën, zonjë. Të gjithë e dinë se unë e kam pritur me padurim ardhjen e tij.

(*Vijnë Simoni dhe Pjetri.*)

SIMONI — Shkuan.

PJETRI — I përcollëm. Edhe Ndoc Gushën e morën me vete.

SIMONI — Të erdhi shërbëtori, ë, dom Zef?

DOM ZEFI — Më në fund... Po t'ju vijë turp ama. Këtë që duhej ta bënit ju, e bëri një njeri i largët për mua. Zoti ju faltë, po keni më shumë fjalë se punë...

SIMONI — Pjetri e ka fajin.

PJETRI — Fajin e ke vetë ti...

GJONI — Mjaft na i shurdhuat veshët! Ladi, ç'rri aty nën hundën e shërbëtorit!

LAJDJA — Po rri në këmbë. (*Tefës.*) Të ta mbush edhe një?

GJONI — Nipçe, thuaji shërbëtorit që të mos rrijë aty si mumje, po të thyejë qafën nga kuzhina!

LAJDJA — Je i keq! Otello...

(*Dom Zefi diçka i thotë Tefës e ai del.*)

GJONI — Ladi, mos u zemëro, shpirt, po këto lodra më fusin xhindet... A po ia marrim një kënge?

MULLA ALUSHI — Natën e mirë, dom Zef!

DOM ZEFI — Prit pak. Ose më mirë eja të të përcjell.
(*E merr për krahu.*) Mulla Alush, e dini si është puna? Një a dy ushtarë shqiptarë kanë dezertuar. Ti që futesh shtëpi më shtëpi, heto mos ka njeri të huaj në mëhallën tënde dhe më lajmëro menjëherë. Hesapi del mirë.

MULLA ALUSHI — Për këtë erdhi ai oficeri? Mos kini hiç merak. Do të hetoj e do t'ju lajmëroj.

Dritat fiken ngadalë. Kur ndizen pas pak për të treguar një periudhë prej disa ditësh, jemi përpara qelës e cila është e rrethuar me mure dhe ka në mes një derë, mbi të cilën duket një kryq prej metali. Në mes të oborrit një man i madh, një plep dhe dy sallgama. Nëpër të është lidhur dhe thurur një hardhi, e cila ka sajuar kështu një tendë. Poshtë ka një tryezë dhe karrige xunkthi. Në njërën prej tyre është ulur sinjor Galoti, i cili vëren herë pas here nga kisha me padurim e vërshëllen një melodi. Përballë duken një copë bregu dhe liqeni. Dëgjohen kambanat që bien për festë. Vjen me ngutje nga kisha dom Zefi.

DOM ZEFI — Më falni, se ju bëra të prisni shumë. Meshë, sinjor Galoti, meshë.

GALOTI — U fole për ushtarin?

DOM ZEFI — U thashë diçka më shumë... (*Qesh nën hundë.*)

GALOTI — Çfarë?

DOM ZEFI — Ne, katolikët, jemi minoritet italian.

GALOTI — Ashtu!

DOM ZEFI — Dje kishim mbledhje në arqipeshkvi. Mon-sinjor De Negrin, delegati apostolik, tha: «Bashkimi shpirtëror me Italinë katolike, kërkon edhe bash-

kimin kombëtar. Fe e përbashkët, dëshira të përbashkëta, qëllime të përbashkëta! Ja, ky është kombi.»

GALOTI — Bukur.

DOM ZEFI — Padre Fausti dhe padre Tracki e mbështetën këtë mendim, ipeshkvi i Pukës e pëlqeu shumë, edhe monsinjor Thaçi u bashkua me ta. U vendos që kjo të mbetet detyrë e përditshme e «propaganda fides»...

GALOTI — Sidoqoftë, në këtë shteg duhet të ecni me kujdes.

DOM ZEFI — Përse u munduat sinjor?

GALOTI — *(I shtrin një zarf.)* Rroga.

DOM ZEFI — *(E merr.)* Ju falem nderit! Tjetër?

GALOTI — *(I jep edhe një zarf tjetër.)* Këtë ia jepni mulla Alushit.

DOM ZEFI — Si urdhëron! Ju shoh të shqetësuar!

GALOTI — Dezertori. Na nxori shpirtin. A keni rënë gjë në gjurmë? *(Dëgjohet zhurma e një karroce që ndalet.)*

DOM ZEFI — Ne po kërkojmë si i verbri gjilpërën në mullarin me kashtë. Na thoni së paku emrin, na sillni ndonjë fotografi.

GALOTI — Njëri e ka emrin Rexhep Alushi e tjetri Vojo Mejdani. Ja dhe fotografia e Rexhepit.

DOM ZEFI — *(Vështron jashtë skene.)* Erdhi xhaxhai. Largohemi, sinjor Galoti, bisedojmë të qetë andej nga bregu i liqenit. Atij i pëlqen të futë hundët kudo. *(Dalin.)*

(Vjen Gjoni duke fshirë djersët.)

GJONI — O Tefë! Nushë, moj! *(Ulet në karrige.)*

NUSHA — *(Nxjerr kokën në dritare.)* Thirri njeri? *(Duket edhe Tefa.)*

TEFA — O, zoti Gjoni!

NUSHA — Mirë se ardhe, zoti Gjon!

GJONI — Ulu e ndihmoi pak Loros për të ngjitur valixhet lart.

TEFA — Menjëherë.

GJONI — Loro, ej, ti, gjumash, luaji duart! Vapë! (*Bën fresk me trinën e dorës.*) Uf, ç'vapë!

(*Duket Loroja me valixhet.*)

— U, harrova në kaloshinë atë... atë, dreqi e han-gjert, atë... nuk po më bie ndër mend emri... Atë, more ti?

LOROJA — Mos u mërzit, zotëri. Sa të çoj unë valixhet lart, do të të kujtohet.

(*Vjen Tefa.*)

TEFA — Ngjatjeta, Loro! (*I jep dorën.*) Ma lësho vali-xhen.

LOROJA — Çadra.

GJONI — Çadra?

LOROJA — E ke harruar në kaloshinë.

GJONI — Ah, për Krisht, i ra në të, hajvani! Tamam çadrën e kam lënë nën sedilje. Pa të nuk mund të luaj as këmbën! Kur e ke atë, e merr hijen me vete ngado shkon. Na ti, Nushë, merre këtë! (*I jep një erash-kë.*) Më bëj fresk, se për zotin, po shkrihem si gjalpi në tigan. Uf, ç'vapë!

LOROJA — Ke vënë shumë dhjamë që kur erdhi Italia, zoti Gjon!

GJONI — Mos e zër në gojë Italinë, se të thyej turinjtë. Na e paske inat Duçen ti, hëm ti, krimb sqolli!

LOROJA — Fashizmi e ka vendin në Itali, atje të fryhet...

GJONI — Të rrijë këtu, se dua unë.

LOROJA — Unë do ta përze.

GJONI — (*Qesh.*) Flet me gjithë mend, budallai, thuajse vërtet e ka në dorë ta përzejë!

LOROJA — Ta përze, është fjalë e butë. Jo, more, po do

ta hedh në det! Aty të fundoset, si atëherë, më një mijë e nëntëqind e njëzetën, harrove?

GJONI — T'u thaftë goja. Eh, ç'të fut xhindet, ky hajvan. Ik, thefish qafën! Shko merr zonjën Lajde.

LOROJA — Lamtumirë; Tefë, Nushë, mirupafshim.

NUSHA — (*Nxjerr kokën në dritare.*) Dole pa një raki.

GJONI — Ujin e ka tepër ky.

LOROJA — Po të ishte me para, hëh, edhe atë do ta vinit në kyç, e do të na linit të ngordhim prej etjes.

GJONI — Tamam si bolshevik flet, qeni. Tfu! Kris, kris, se për Krisht, do të vijë dita... Tefë, më lehtë atë erashkë, se ma përziën ajrin e më merr frymën. Mirë, ashtu, ngadalë. Thashë... Po, do të vijë dita, mbaji mend këto fjalë, e mos u zgërdhi, kokëbosh. Do të vijë dita që të të vë prangat me duart e mia, e të të plas në burg.

LOROJA — Po pastaj kush do të të shpjerë me karrocë?

GJONI — Sille shejpt zonjën Lajde, dëgjon. Edhe ruaje nga gropat, mos e troshit, hajvan, se është me bajame. (*Tefës*) Ngjitu lart! Kam në valixhe një palë brekë banjo. Më sill edhe robdëshambrin. Është një veshje si xhybja e mulla Alushit, po bojë kafe, ama. Ik! (*Tefa shkon në qelë. Vjen dom Zefi.*) Ah, ja më në fund edhe i zoti i shtëpisë.

DOM ZEFI — Mirë se erdhe, xhaxha!

GJONI — Hë, nipçe, si je. Vapë! Kam ardhur të rri një muaj.

DOM ZEFI — (*I habitur.*) Një muaj!

GJONI — Me harxhet e mia, kuptohet, si në hotel. Nuk del vaj nga guri. Rri. Të njoh. Pra, nuk të bie në qafë për hiçgjë. Banjën dua ta filloj që tani, sa të më sjell Tefa brekët. Pse më shikon ashtu? Doktorët më thanë: «Shko te nipi, lëviz shumë, lahu, bëj banjë dielli...» Kaq. Jam bërë sa një balenë, e marr-

të e mira. Jo, e marrtë dreqi! Ja, shiko si më kullojnë në djersët në fytyrë! Do të jepja gjysmën e pasurisë po të bëhesha si... si të gjithë. Të eci njëherë ashtu lirisht, bre nipçe, pa...

DOM ZEFI — Gjysmën e pasurisë, the?

GJONI — Gjysmën jo, po çerekun...

DOM ZEFI — Dua vërtetim, se ndryshe s'të zë besë...

GJONI — Ja, merre! (*I shtrin një zarf.*)

DOM ZEFI — (*E merr,*) Ç'është?

GJONI — Fitimi i kontratës së mishit për ushtrinë.

DOM ZEFI — Kaq pak? Unë kam shënime të sakta të fitimit të përditshëm.

GJONI — Dëgjo; nipçe i dashur, afro pesëdhjetë kuinalë mish u prishën dhe na u desh t'i hidhnim në Bunë.

DOM ZEFI — Mos e tepro, nuk mund të ma marrësh fitimin. Të kam në dorë. Kontrata është në emrin tim.

GJONI — Ishte, nipçe. (*I tund kontratën ndër hundë.*)

DOM ZEFI — Ishte!? (*Vështron kontratën i përqëndruar.*)

GJONI — E mësova marifetin. Gjeneral Benetit, i kam vënë trastën e tagjisë në qafë, e ha me ëndje e qetësi, tamam si kali i kaloshinës sime, nipçe. Tefë, ec se më kaloi ora e banjës. (*Del. Dom Zefi sillet për pak i kredhur në mendime. Vijnë Simoni dhe Pjetri.*)

SIMONI — Mirë që të gjetëm këtu, zotëri.

PJETRI — Mos je gjë sëmurë, që je prishur në fytyrë, dom Zef?

DOM ZEFI — Dhembje koke... (*E merr veten.*) Ç'kemi? Hë, ç'thotë populli për meshën e sotme?

SIMONI — Ajo puna që ne qenkemi italianë i ka pezmatuar shumë...

PJETRI — E ëma e Nush Gjokës, atij peshkatarit që u mbyt vjet, të shau e inatosur.

DOM ZEFI — Aq mend ka ajo dhe të tjerët që mendojnë ashtu. Në letrën e parë të papa Juanit, në kreun e dytë, vargu pesëmbëdhjetë e gjashtëmbëdhjetë, thuhet: «Mos e doni botën dhe ato që gjenden në të; nepsi i trurit, nepsi i syve dhe kryelartësia e të jetuarit nuk janë të atit, por të kësaj bote mëkatare». Pra, bota e kombësia, nuk janë asgjë para fesë. Vetëm feja është e atit të amshuar.

SIMONI — Mirë, mirë, dom Zef, po ec mbushju mendjen atyre...

DOM ZEFI — Kombi është trillim i njeriut, kurse feja është krijim i atij të lumit atje lart. Kush ka vlerë?

PJETRI — Feja, feja.

SIMONI — E patëm kombin, po gati ndordhëm urie. Rroftë fashizmi!

DOM ZEFI — Ju edhe të krishterët e tjerë të mirë e të devotshëm, duhet të çoni në popull fjalët e mia, si fjalët e Krishtit, lavdëruar qoftë emri i tij!

TË DY — Amen!

DOM ZEFI — Ç'kemi ndonjë të re?

SIMONI — Të premtën, dom Zef, edhe Mulla Alushi u paska folur fshatarëve në xhami, e u paska thënë se fashizmi është një peshqesh i allahut,

PJETRI — Mirëpo, në mbrëmje, i paskan dalë para dy njerëz të panjohur dhe e paskan rrahur paq. «Edhe kjo e rrahur është peshqesh i allahut, hoxhë efendi», — i paskan thënë. (*Qesh.*)

DOM ZEFI — (*I vëren si me inat.*) Mjaft nxorët dhembët, nuk ka asgjë për të qeshur, përkundrazi...

SIMONI — Me këtë punë po merret policia.

DOM ZEFI — Harruat kryesoren, ushtarin. Hë, keni rënë dot në erë? Ata miqtë thonë se informatat sillen

- e përsillen këtu!
- SIMONI — Më duket se, më duket se... ka ikur prej këtej.
- PJETRI — Nuk kishte si të rrinte këtu, pas gjithë asaj që ndodhi atë natë. Pastaj Ndoc Gusha po kalbet në burg. Ku të strehohet?
- (*Vjen Agetina e ndalon tek dera.*)
- DOM ZEFI — (*Simonit e Pjetrit.*) Në breg keni xhaxhanë, shkoni përpara se po vij edhe unë më pas. (*Të habitur nga prerja e papritur e bisedës, shohin Agetinën e largohen. Dom Zefi vrapon drejt saj i shqetësuar.*) Agetinë, ç'është? Shih si je bërë... nuk fshihet më... Mos e mundo veten, o ëngjëlli im.
- AGETINA — Erdha me karrocë dhe zbrita larg pikërisht që të mos më shihnin këta dy llafazanët, por ja që i gjeta këtu.
- DOM ZEFI — Edhe hije po të bëhesh, nuk ke si u shpëton syve të njerëzve. Mos e prish gjakun për këtë. Hë, më thuaj, si shkojnë punët?
- AGETINA — Ndreka është kaq i lumtur, sa, të të them të drejtën, më inatos lumturia e tij.
- DOM ZEFI — E ka kuptuar që je... (*I tregon barkun.*)
- AGETINA — Jo zotëri, ai nuk e vret mendjen për të tilla gjëra. Në u kujtoftë për muajt, do t'i them linda para kohe. Por unë erdha për diçka tjetër. Më duhen njëqind napolona për të blerë diçka për foshnjën dhe diçka për vete. Edhe Ndrekes do t'i blej një palë rroba vere, se i veshur keq duket i shëmtuar. Ti e kupton sa e rëndë është për mua që të kem ndër sy ditë e natë një torollak...
- DOM ZEFI — (*Vëren jashtë.*) Ngjitemi lart e bisedojmë se po vjen Luca, ai berberi që nuk ka një, po dhjetë gojë. (*Futen në qelë.*)

(Hyn Luca me veglat e berberit ndër duar.)

LUCA — O Tefë! Tefë!

NUSHA — *(Duket në dritare.)* Në breg të liqenit e ke.

LUCA — *(Vështron andej.)* Ah, ja, qenka me zotin Gjon më duket. Thirre ti, Nushë, se kam frikë nga fuçia me dy këmbë mos më kapë prapë për ta rruar.

(Nusha e thërret dhe Tefa vjen duke vrapuar.)

LUCA — *(Disi nën zë.)* Shkova në punishten e lëkurëve. Doli ai punëtori. E lexoi letrën tënde, bëri buzën në gaz e tha: «Të rrijë aty te prifti edhe disa ditë, derisa të gjejmë një vend më të sigurtë.»

TEFA — Më duket se dom Zefi më shikon me një farë dyshimi.

LUCA — Nuk është e mundur. Ashtu të duket.

TEFA — Po sikur të takohet rastësisht me Bibë Ndoun, ose sikur t'i dërgojë ndonjë letër falënderimi?

LUCA — Edhe ne diçka do të nuhasim. Punë ditësh është...

TEFA — Lucë, më thuaj çfarë thonë kur rrëfepen, se unë s'di gjë fare.

LUCA — Fut ca rrena dhe je në rregull. Nise kështu: «Ave Maria misericordum — thuaj ca fjalë me us, me um e me sum dhe pastaj ç'të të vijë ndër mend.

TEFA — A ka rrezik të më njohin nga fotografia?

LUCA — Jo sinjor Galoti, po as yt atë, po t'i dalësh kështu nuk të njeh, aq shumë të kam ndryshuar.

(Hyn nga porta e rrugës murgesha. Ecën kokulur dhe murmuron diçka. Kalon afër tyre, si e verbër. Drejtohet për në qelë. Dom Zefi si duket e ka parë prandaj del në dritare fluturimthi.)

DOM ZEFI — Motër, motër, më prit në kishë, të ndih të zoti!

MURGESHA — *(Do t'i kundërshtojë, po kur i venë sytë te Luca e te Tefa, ul kokën përvuejtërisht e shqipton:)* Mirë, domine... *(Kthehet e shkon në kishë.)*

DOM ZEFI — *(Lucës.)* Pse erdhe?

LUCA — E sheh vetë, zotëri. *(Tregon veglat.)* Ke ditën sot.

DOM ZEFI — Tani e tutje do të rruhem vetë. I kam blerë veglat.

LUCA — *(Me ankim të thekshëm.)* Edhe këtë fitim të vogël po ma heq?

DOM ZEFI — Ia hoqa vetes. Nuk mund të rruhem nga një njeri që ka kushedi sa kohë që nuk ka shkelur në kishë, e kushedi sa kohë që nuk është rrëfyer...

LUCA — Aty e ke hallin? Po vij këtë të diel.

DOM ZEFI — Edhe të rrëfehesh, të ruajtë Krishti.

LUCA — Nuk prishemi, dom Zef. Të të rruaj?

DOM ZEFI — Padsreke. *(Futet brenda.)*

LUCA — *(Tefës.)* E marr me mend ç'kërkon nga rrëfimi im, sepse... *(I mbetet fjala në gojë, meqë ka parë të hyjnë nga rruga një oficer dhe dy karabinierë.)* Oh! *(Tefës.)* Shenjë e keqe.

OFICERI — Ej, ec këtu!

LUCA — *(Tefës.)* Zhduku ti! *(I afrohet oficerit.)* Urdhëro, sinjor.

OFICERI — Shërbëtori i famullisë je ti?

LUCA — Berberi.

OFICERI — Barbieri!

LUCA — Erdha për të rruar famulltarin tonë.

OFICERI — Ku është ai?

LUCA — Lart.

OFICERI — Me kryeplakun, hë?

LUCA — Unë nuk e pashë kryeplakun, sinjor.

- OFICERI — Na thanë se është këtu së bashku me zotin Pjetër, anëtarin e kryepjeqësisë.
- LUCA — Pritni, sinjor, të pyes shërbëtorin. Ore Tefë, a janë këtu Simoni e Pjetri?
- TEFA — Janë në breg të liqenit, duke kuvenduar me zotin Gjon. Po i thërres. *(Del me vrap.)*
- LUCA — Urdhëroni e pushoni pak nën hije.
- OFICERI — S'kemi kohë.
(Vijnë duke vrapuar Simoni dhe Pjetri.)
- SIMONI — Salute!
- PJETRI — Salve!
- OFICERI — *(Nën zë.)* Kemi ardhur të bëjmë bastisjen e shtëpive të Rrok Furtunës dhe të Selim Sertit.
- SIMONI — Po përse?
- OFICERI — Kemi urdhër. Hajde na pri përpara *(Dalin.)*
- LUCA — Me ç'nuhas unë me këtë hundë, Rexhep, për ty kanë ardhur.
- TEFA — Dhe unë duhet të largohem menjëherë.
- LUCA — Ngadalë, merre më shtruar. Nuk të sollëm këtu sa për të të hequr qafe, po pse nën çatinë e dom Zefit je si nën pëllëmbën e tënzot... *(Qesh. Dëgjohen rrotat e kaloshinës nëpër rrugë.)* Ih, ih, ih, kush po vjen; zonja Lajde. Ika, ika, mirupafshim! *(Del. Te dera ndeshet me zonjën Lajde, e cila është veshur shumë mirë, me kapelë me strehë të madhe, syze dielli, çadër me lule, erashkë. Duket që ka vapë. Loroja i shkon prapa me një valixhe në dorë. Diçka do t'i thotë Lucës, po kur sheh Tefën drejtohet për tek ai.)*
- LAJDJA — Oj, Tefa! Ec këtu më jep dorën. Ashtu. Jo. Ma fut këtu nën sjetull. U? I vjen turp! Hëm, budallai! Në Itali, Tefë, kjo është për niente. Ku është Xhovani?

TEFA — Po lahet në liqen.

LAJDJA — Nuk më ka pritur mua! Uh, sa inat më vjen! Ti, Tefë, më prit këtu, dëgjon? Unë po shkoj të vishem. Pastaj, ti më përcill atje në breg... *Nela spi-axha*, si thoshin atje në Lido di Roma. Lahemi bashkë.

TEFA — Unë nuk di të lahem. Pastaj duhet t'i marr leje dom Zefit.

LAJDJA — Fshatar... *bel kontadino!* (Shkon të vishet. Pas i shkon edhe Loroja. Nga bregu dëgjohej uturimë motori që afrohet. Tefa futet në qelë me ngutje. Duket kiçi i motoskafit, prej nga zbret Galoti. Dom Zefi vjen duke rendur e i del para me shumë përzemërsi e përulje.)

DOM ZEFI — Mirë se erdhët, mirë se erdhët, sinjor Galoti! Urdhëroni lart Nushë!

GALOTI — (*Ulet në një karrige.*) Rrimë këtu. Mos thirr asnjëri. Kam një bisedë shumë sekrete me ju. (*Fshin djersët*). Kemi një informatë se ushtari që kërkohet më është në shtëpi të mulla Alushit.

DOM ZEFI — O burra! Ç'e zgjasni, sinjor Galoti, kapeni!

GALOTI — Eh, domine, ai ushtari na bëri qesharak. Bëmë kaq bastisje dhe përfundimi: asgjë! Mirëpo, të futësh hundët në shtëpinë e një hoxhe, nuk është shaka; tërë besimtarët varin turinjtë dhe bëhen të pakënaqur nga gabimi ynë. Prandaj këtë informatë duam ta verifikojmë.

DOM ZEFI — Po qysh?

GALOTI — (*Ndez cigaren.*) Ti ke një shërbëtor?

DOM ZEFI — Ju kam folur për të...

GALOTI — Më keni thënë se është i shkathët, i zgjuar dhe i besës.

DOM ZEFI — Sidomos ndaj meje, si i zoti dhe si prift.

- GALOTI — Thirreni. (*Dom Zefi bën një gjest që s'kupton gjë.*) Durim, do ta merrni vesh menjëherë. Thirreni!
- DOM ZEFI — Tefë! Tefë! (*Tefa duket në prag.*) Afrohu, biri im.
- GALOTI — Afrohu, afrohu, mos ki frikë.
- TEFA — Jo, jo... nuk kam frikë unë.
- GALOTI — Zoti dom Zefi më ka thënë fjalë të mira për ty.
- TEFA — Nderon veten, zotëria im, se është i nderuar...
- GALOTI — Ti nuk e merr me mend se kush jam unë, hë?
- TEFA — Jjjo...
- GALOTI — Jam i policisë. Kaq. Pra, ne duam të të ngarkojmë një punë...
- TEFA — Nuk i marr anën asnjë pune unë.
- GALOTI — E njeh mulla Alushin?
- TEFA — E njoh.
- GALOTI — Shtëpinë ia di?
- TEFA — Ia di.
- GALOTI — Do të shkosh të shkruash tek ai një nuskë për bagëtinë.
- TEFA — (*Bën kryq*). Mos e dhëntë, zoti! Unë jam katolik, e nuk e shkel prapun e tij edhe sikur të më ngordhin gjithë bagëtia, po të kisha.
- DOM ZEFI — Dëgjo, biri im, fol vetëm kur të pyesin.
- TEFA — Dom Zef, unë...
- DOM ZEFI — Mos e prish gjakun kot së koti, të ruajtë Krishti. Ke lejen time për të bërë ç'të të thotë sinjor Galoti.
- GALOTI — Vazhdojmë? Hapi veshët mirë, djalosh. Ne po të besojmë një punë me rëndësi, sepse je shërbëtor i dom Zefit. Dëgjo! Kemi informatë se në shtëpinë e mulla Alushit gjendet një dezertor. Ti do të shkosh te hoxha për të shkruar nuskën. Do

t'i japësh një shumë të mirë të hollash. Ke për të kaluar tek ai drekën, edhe darkën po të jetë nevojë. Të mos dalësh prej andej pa parë çdo skutë, kupton?

TEFA — Do të më njohë, zotëri.

GALOTI — E kemi menduar edhe atë. Ti do të jesh mälësor i ardhur nga një fshat i Pukës. (*Fshin djersët.*) Vapë!

DOM ZEFI — Ngjitemi lart, sinjor Galoti, pimë diçka freskuese.

GALOTI — Mirë thua. E bisedojmë atje këtë çeshtje më hollësisht. (*Duket Luca me veglat e rrojës. Galoti hyn në qelë.*)

DOM ZEFI — Ke ardhë pa kohë, të ruajtë Krishti. (*Futet në qelë pas mikut.*)

TEFA — (*Nën zë.*) Kam nevojë për ty, Lucë.

LUCA — Fol!

TEFA — Ec këtu pasi të iki Galoti. (*Hyn në qelë edhe ky.*)

LUCA — (*Ka ngelur i hutuar.*) Pasi të iki Galoti! Ec merre vesh më hollë. Sidoqoftë, nuhas një rrezik... (*Del duke vrapuar.*)

Perdja

PJESA E DYTË

Po aty pas disa ditësh.

Është mëngjes herët. Tefa diçka gërmon me shat, ndërsa Nusha vadit lulet që gjenden para qelës.

NUSHA — E mira e të mirave është të rrish nën hije, biro...

TEFA — Hija më pëlqen edhe mua, por... *(Dëgjohet uturima e motoskafit.)* Ja, nuk të lënë...

NUSHA — Ik!

TEFA — E ku të vete? Nuk dua të dyshojnë për asgjë... Dua të them të mos më marrin për një dembel që i pëlqen hija... *(Duket kiçi i motoskafit dhe Galoti që rri në këmbë. Tefa vrapon dhe e ndihmon të zbresë.)*

GALOTI — Bonxhorno, djalosh! Për ty kam ardhur. Të lumtë! *(I bie supeve.)* Ke bërë një punë të pastër... *(Vjen dom Zefi me ngutje.)* Bonxhorno, dom Zef!

DOM ZEFI — Zoti ju bekoftë ditën, sinjor!

GALOTI — Erdha t'ju falënderoj për ndihmën që na dha shërbëtori juaj. Pikërisht për këtë duam t'i japim një bakshish. *(I shtrin ca kartmonedha.)* Merri!

TEFA — Jo, jo, zotëri.

GALOTI — Merri, janë të tuat.

TEFA — Unë paguhem nga dom Zefi, zotëri.

DOM ZEFI — M'i jepni mua, sinjor. Ia jap më vonë, se tani i vjen turp nga ju... (*Ia merr të hollat nga dorë.*) Urdhëroni lart!

GALOTI — Jo, vemi në breg e bisedojmë. (*Dalin.*)

NUSHA — Ç'deshi të të japë ai oficeri?

TEFA — Para.

NUSHA — I mori prifti? (*Qesh.*) Hëh, nuk do t'i shohësh me sy kurrë më!

TEFA — Kam neveri t'i shoh, Nushë. (*Dëgjohen thirrjet e mulla Alushit nga jashtë.*) Po vete brenda unë... (*Hyn në qelë.*)

MULLA ALUSHI — Mallëkim! Hata e madhe! Iu shof-të hisja e diellit atij ose atyre që duan të më hapin varrin pas shpine. Allah, shtrihe kërbacin mbi ta, e bjeru, bjeru me rrufe e batare! Bjeru! Shfreje tërbimin tënd të shenjtë mbi armiqtë e mi. Ooo, u prish dynjaja, dom Zef! (*Hyn në oborr.*) I hap derën tjetrit, e fut brenda, i shkruan një nuskë me bekim të allahut, e lë edhe të bëjë mriz nën çatinë tënde, e kur unë i shkreti shtrihem bashkë me gratë për të bërë pushimin e drekës, ai katil ngrihet e hap një varr mu aty në këmbët e mia! E kujt ia bën këtë? Mua, fashistit! O dom Zef, dom Zef!... Uh, nuk qenka këtu! Po këtu ishte ai, e pashë mirë. Ç'u bë, moj Nushë, zotëria yt?

NUSHA — (*Duke hyrë në qelë.*) Në breg.

MULLA ALUSHI — A, në breg qenka, O, dom Zef! Komshi! O zotëri! O miku im për kokë! (*Vjen dom Zefi.*) U bë kiameti mbi shtëpinë time! Duan të më prishin me Duçen, horrat, katilat, mua? Dom Zef, më ndihmo, ma jep dorën e më nxirr nga varri ku duan të më gremisin ata... armiqtë e mi e të Duçes, he iu lëshofsha allahun, të pafeve!

(Vjen Galoti.)

GALOTI — Shshsht! Qetësohuni, hoxhë! Ky nuk është muhabet pazari. Ne të thamë, po të lëmë të lirë që të gjesh ushtarin, e jo të lëshosh kujën!

MULLA ALUSHI — Ku ta marr ushtarin, hë më marr-të mortja mua!

GALOTI — Durim, do të të vijë në vesh se ku ka vajtur, pasi ka ikur nga shtëpia jote. Por po të dalësh kështu duke thirrur në vend që ta afrosh, do ta largosh.

MULLA ALUSHI — Kë largoj?

GALOTI — Ushtarin.

MULLA ALUSHI — O, dëgjo ky! Atij nuk ia kam parë surratin kurrë, pasha...

GALOTI — *(Ia pret me të keq.)* As kur e kishe në shtëpi?

MULLA ALUSHI — Gjithnjë atij teli i bie ti. More, dëgjo, unë jam fashist, bile unë e dua Duçen edhe më shumë se ti, se ti ha rrogë të majme prej tij, prandaj e do, kurse unë...

GALOTI — Po fotografinë e Zogut ama, e kishe varur në murin e dhomës...

MULLA ALUSHI — Gratë, marroqet, e kanë harruar aty... se unë lartmadhërinë... atë lart... atë laro... Pasha allahun, unë kam lindur fashist, se gjithmonë me veshje të zezë kam ndenjtur.

GALOTI — Po xhaketën ushtarake të ushtarit në fjalë, që e gjetëm të varur ngjitur me xhyben tënde, kush e solli aty? Po librezën ushtarake që e gjetëm brenda saj?

MULLA ALUSHI — Trillime, trillime fund e majë... pasha qimet e Pejç...

DOM ZEFI — Mulla Alush, faktet flasin vetë...

MULLA ALUSHI — Edhe ti u zë besë këtyre dokrave,

dom Zef? Bukur! Aferim, aferim, dom Zef e ta paça borxh...

DOM ZEFI — Nuk kam miqësi me atë që fsheh armikun tonë në shtëpi...

MULLA ALUSHI — Unë armik? Ah! Mbaje gojën, bre! GALOTI — (*Paqëtues.*) Merreni më shtruar, zotërinj.

Nuk është fjala se ti je armik, hoxhë, po pa dashur je bërë jatak i armikut... Ti je yni e do të mbesësh i yni, mulla Alush. Kam bindje për këtë... E kuptoj se ti, si hoxhë, e ke të zorshme të na futësh në dorë ushtarin se është mysliman e të duket mëkat e tradhti... por duhet ta kuptosh se armiku ynë është edhe armiku yt, bile armiku i të gjithë besimtarëve.

MULLA ALUSHI — More sinjor Galeta...

DOM ZEFI — Galoti.

MULLA ALUSHI — Mirë, Galoti... Unë as në ëndërr s'e kam parë ushtarin që thoni ju, pasha qimet...

GALOTI — E mbyllim këtë bisedë.

MULLA ALUSHI — Atë dua, ta mbyllim, se është marrëzi të më veshësh mua, mulla Alushit, një faqe të zezë si kjo. Dom Zefi e di se me sa padurim e kam pritur unë Duçen. Eviva!

DOM ZEFI — Hoxhë, mos bëj dredha!

GALOTI — Ne duam prej teje ushtarin, se ti e ke fshehur nën xhybe ... Dorëzimi i ushtarit do të jetë dëshmi e madhe e dashurisë dhe e besnikërisë sate ndaj Duçes.

MULLA ALUSHI — Eviva! (*Ngre dorën.*) Ushtarin s'kam ku e marr, pasha qimet e Pejkamberit. Po t'ju hyj në punë unë, ja tek më kenë. Por, ama, po jua them përpara: do të bini në sherr me kryemyftiun tim. Ka për t'u çuar me urysh: «Lëshojeni hoxhën tonë! Është i pafajshëm! Është fashist i flaktë!»

GALOTI — Shko, mulla Alush, shko e na lër të qetë, se kemi punë.

MULLA ALUSHI — Si urdhëron, shkoj unë. Eviva!
(*Del.*)

GALOTI — Oooo! (*Zë kryet me pëllëmbë.*) Edhe në kusturë kështu na nxori veshët, si gjinkalla. Bën zhurmë për të fshehur ushtarin, por edhe më shumë e zbulon.

DOM ZEFI — Ushtarin nuk e nxjerr nga xhybja, po nuk ia grisët me forcë, sinjor Galoti...

GALOTI — Populli juaj ka një proverb të bukur: «Qeveria e zë lepurin me qerre». (*Qesh.*) Kështu do ta zëmë, po meqenëse është hoxhë... (*Kalojnë nga bregu. Pas pak dëgjohet uturima e motoskafit që largohet.*)

Pas disa ditësh. Qela duket brinjazi dhe aty afër një copë liqeni.

MULLA ALUSHI — (*E sheh.*) Dom Zef, ngjatjeta! Si je e ku je?

DOM ZEFI — O, mulla Alushi! Na i ke bërë sytë ujë. Kam një javë që nuk të kam parë. Përse je munduar. Apo ke ndonjë haber për...

MULLA ALUSHI — Për hallet e të tjerëve, dom Zef. Për hallet e milletit...

DOM ZEFI — Bjeri shkurt, mulla Alush.

MULLA ALUSHI — Si urdhëron! Po në fillim trokitet në derë, pastaj hyhet, pastaj... (*Kollet për të çelur zërin.*) Kam marrë vesh se Duçja i madh, që perëndia ia shtoftë ymrin, dashka të ndajë ijane.¹⁾

1) Ijane — lëmoshë që jepnin fashistët për të fituar simpatinë e të varfërve, po shumica e refuzonte si gjë të turpshme dhe poshtëruse.

Unë në lagjen time kam dyqind e njëzet e dy frymë. Kam bërë listën emër për emër. (*Ia tregon.*) Dyqind e njëzet e dy frymë. Ne, unë e ti domethënë, jemi bashkë, një fshat, një shtëpi, si të thuash: të mirat e të këqijat i ndajmë me njëri-tjetrin. (*Qesh me nënkuptim.*) Ti e di gjuhën e këtyre miqve, dom Zef, e të ecën më mirë fjala. Merre listën, të lutem!

DOM ZEFI — (*E merr.*) Mirë...

NUSHA — Sa vetë ke shtuar, mulla Alush?

MULLA ALUSHI — Për qimet e Pejamberit, asnjë... asnjë. E? Prit. Po. Jo, se do të vdesim dhe gënjeshtër është haram. Kam shtuar dhjetë frymë. Por, po ta shikosh hollë-hollë, as ata nuk janë shtuar. Në lagjen time dhjetë gra janë shtatzëna. Kështu që, po ta shikosh punën me drejtësi fashiste... Viva! (*Çon dorën lart.*) Secili prej atyre që do të lindë, djalë a vajzë qoftë, kërkon hisen e vet.

DOM ZEFI — Mirë, mulla Alush, e rregullojmë. Po me ushtarin si u bë puna?

MULLA ALUSHI — E kapën.

DOM ZEFI — E kapën?! Kë?

MULLA ALUSHI — Atë... atë që vrau oficerin...

DOM ZEFI — Ushtarin?

MULLA ALUSHI — Dorën vetë. I kanë vënë prangat: fap! E pashë me sytë e mi atje në qytet, se ja, prej andej po vij tani. Pyeta një mik që e kisha në krah, e që është me rëndësi aty në polici, e ai më tha: ka vrarë një oficer fashist. Ah, mora frymë. Shpëtuam, thashë, shpëtuam, zoti dom Fef, se ngado shkoja, atje e kisha mendjen, dëgjon? Edhe duke u falur, pasha qimet e Pejamberit, atje. Ah, ai katil, thosha, kur ta fusin në thonjë këta fashistët, atëherë do të qetësohem. M'u hoq dhe mua njolla.

DOM ZEFI — Mirë, mirë, mulla Alush, po kur e kishte
vrrarë oficerin ai djaloshi?

MULLA ALUSHI — Para dy javësh. Ai oficeri i kishte
hyrë me forcë në shtëpi...

DOM ZEFI — Atëherë do të jetë tjetër. Ai e ka vrrarë
te ura e Bahçallëkut.

MULLA ALUSHI — Pasha allahun vapa më ka trullo-
sur fare.

DOM ZEFI — Shko e freskohu, mulla Alush. Kush the
se më priste te porta?

MULLA ALUSHI — Një djalë i vogël.

DOM ZEFI — Bëj pak mundim e thuaji të vijë bren-
da. (*Hoxha del e pas pak hyn një djalë i vogël.*)
Kë kërkoni, biri im?

DJALOSHI — Dom Zefin.

DOM ZEFI — Me hirin e zotit, jam unë vetë. Po ju
kush jeni?

DJALOSHI — Jam shërbëtori.

DOM ZEFI — Shërbëtori im?

DJALOSHI — Ëhë. Më ka dërguar kryeplaku, Bibë
Ndou.

DOM ZEFI — Bibë Ndou? Pse a mos ka luajtur nga
mendja?

DJALOSHI — Nuk e di.

DOM ZEFI — (*E vëren me vëmendje.*) Sa shërbëtorë ka
ndër mend të më dërgojë Bibë Ndou?

DJALOSHI — Aq sa i keni kërkuar...

DOM ZEFI — Një.

DJALOSHI — Dhe ja tek erdha.

DOM ZEFI — Po para teje më dërgoi një shërbëtor tje-
tër.

DJALOSHI — Sa keq. Më gënjeu. Më tha për një shër-
bëtor si ty ka nevojë dom Zefi.

DOM ZEFI — E pse?

DJALOSHI — Ku di unë...

DOM ZEFI — (*E vëshgon për një grimë.*) Ku di ti?

DJALOSHI — Ai më tha se këtu sillen nëpër oborr gra e burra lakuriq. Diçka e çuditshme, ë? Po, unë, mos kujto se jam i humbur, zotëri. Si e shihni edhe vetë nga veshja ime unë nuk ngjaj me një fshatar.

DOM ZEFI — Më falni, po nga vini ju, biri im?

DJALOSHI — Nga Tirana. Kam qenë shërbëtor te Kolë Serreti. Ishte deputet burri i botës. Atje kam mësuar si duhet të flasë shërbëtori me zotërinë, me zonjat, me miqtë etj. Fundi, unë di të shërbej italiane, zotëri. Keni për të parë.

DOM ZEFI — (*Me interesim.*) Pse u larguat prej andej?

DJALOSHI — Nuk u largova, po më përzunë.

DOM ZEFI — Të përzunë?

DJALOSHI — Ëhë. Iu erdhi shërbëtori nga Italia atyre, e mua më thanë ik tani...

DOM ZEFI — E të hodhën këtu, tek unë, hë?

DJALOSHI — Ëhë. Jo, domethënë më kthyen në fshat. Mirëpo, Bibë Ndou më tha: «Ti je tamam shërbëtor për dom Zefin». E unë, ja, erdha.

DOM ZEFI — (*Thërret*) Tefë! Harrova se e kam dërguar në pazar. Djalosh, unë e kam një shërbëtor që më ka dërguar Bibë Ndou para dy muajsh.

DJALOSHI — (*E vren i pakënaqur*) Mos ke kërkuar dy, zotëri?

DOM ZEFI — Një.

DJALOSHI — (*I dëshpëruar*) Domethënë, vendi qenka i zënë.

DOM ZEFI — I zënë djalosh.

DJALOSHI — Atëherë, po shkoj, e di se jam njeri i pafat.

DOM ZEFI — I pafat?

DJALOSHI — Ehe, domethënë, gjithnjë më këputet fija e nafakës mua... Hajt, ngjatjetani. (*Niset të dalë.*)

DOM ZEFI — (*I shkrep një mendim*). Mos ka ndonjë ngatërresë.

DJALOSHI — Urdhëro zotëri!

DOM ZEFI — Ja, djalosh. Ç'do të bësh. Të vesh te Bibë Ndou t'i thuash se të kërkon Dom Zefi.

DJALOSHI — Ai u nis për në Pukë, zotëri.

DOM ZEFI — Shko djalosh. Të priftë e mbara!

DJALOSHI — Hajt, ngjatjetani! (*Del.*)

Perdja

Jemi përsëri në dekorin para qelës. Nga kisha del dom Zefi, e pas tij ecën Tefa.

DOM ZEFI — Po biri im duhet të rrëfehesh. Njeriu lahet nga ndonjë mëkat dhe pas rrëfimit e ndien veten më lehtë.

TEFA — Gjethe zotëri, gjethe. (*Bën kryq.*) Në emër të atit të birit e të shpirtit të shenjtë.

DOM ZEFI — Mjaft të bekoftë krishti. Paqja e rrëfimit ruan shpirtin nga mëkati.

Vijnë nga rruga Simoni dhe Pjetri.

DOM ZEFI — (*Tefës*) Shko lart tani biri im, merr enët dhe ec e mbush ujë.

TEFA — Si urdhëron! (*Shkon në qelë.*)

SIMONI — Qoftë lavdëruar Jezu... Ç'shikon ashtu dom Zef?

DOM ZEFI — Mua t'më bëjnë sylesh! (*Vren andej nga doli Tefa.*)

PJETRI — Ç'ka ngjarë zotëri?

DOM ZEFI — Shsht! (*Del Tefa me enët. Dom Zefi tërhiqet dhe mban qëndrim të qetë kur kalon ai.*)

Sot u paraqit një shërbëtor tjetër që e çonte Bibë Ndou. Dyshoj.

SIMONI — Heu! Po ti e ke një shërbëtor.

PJETRI — O Krisht!

DOM ZEFI — Shshsht! Flisni më lehtë. Mos na kanë kurdisur ndonjë lodër, me qëllim...

SIMONI — Nuk ka se si, zotëri.

DOM ZEFI — Këtu ka diçka. Mos Tefa s'është ai shërbëtori që duhej t'më vinte, siç duket ma kanë sjellë derisa të kalojë stuhia...

PJETRI — Oi, pse peshkatar është ky?

SIMONI — Rri ti, se nuk kupton.

PJETRI — Oh, ti je i mençur shumë!

DOM ZEFI — Mos bëni si kalamajtë kur bisedohen çështje të rëndësishme. Hapini veshët mirë! Tefa, shërbëtori im, ndoshta është ai ushtari që ka vrarë tek ura e Bahçallëkut atë oficerin italian.

PJETRI — Baaah! Po sikur të jetë ai shërbëtori tjetër. Pse e lat të ikte?

SIMONI — Uh, uh, uh!

DOM ZEFI — Ai ishte i vogël. S'mund të jetë ushtari që kërkojmë... Desha ta thërres Bibë Ndoun, atë kryeplakun që ma pat dërguar, por ai nuk gjendej në fshat, se paskësh vajtur në Pukë më tha vetë djaloshi.

SIMONI — Kot dyshoni zotëri dom Zef, po ne u tham atyre të kuesturës për një tjetër dhe ata e kapën.

DOM ZEFI — Ndoshta s'është ai, ne u tham ta verifikojnë.

PJETRI — Sinjor Galoti tha se e ka pranuar fajin.

SIMONI — E, bile, ai na përgëzoi... Sigurisht ty më shumë, zotëri...

DOM ZEFI — Kam dyshim, e zoti më faltë, miqtë e mi, po ngaqë u kishte ardhur shpirti në majë të hun-

dës Galotit me shokë, kanë bërë ç'është e mundur që ta bëjnë fajtor të gjorin... për t'u çliruar nga ai ushtari...

PJETRI — Ashtu është, dom Zef, se policia ka dajak me xhunga, e, po të ra shpinës, bam, edhe zorrët e barkut të dalin nga goja... Bam! Thuaj e ke vrarë! Bam! Thuaj! Bam! Thuaj! Fundi një shpirt ka kushdo, e... me një mijë dreqe! Po, e kam vrarë.

SIMONI — Po si ka mundësi të jetë Tefa. Ai ushtari që vrau oficerin është mysliman. Mos vallë shërbëtori yt të jetë mysliman?!...

DOM ZEFI — Dhe mund të jetë mysliman. Unë do ta thërres nesër në mëngjes të rrëfëhet dhe do ta kup-toj më mirë.

PJETRI — Pse të mos njoftojmë kuesturën.

SIMONI — Duhet lëvizur se mos na ikën.

DOM ZEFI — Mos u ngutni, e kemi në dorë. Ai nuk dyshon aspak se i kam rënë në erë. Të jemi më të sigurtë për personat që dërgojmë atje.

(Vjen nga rruga Agetina. Nusha duket në dritare.)

AGETINA — Dom Zef, ec pak lart të lutem, se kam një bisedë të ngutshme...

DOM ZEFI — Po bija ime, tani. *(Atyre të dyve nën zë.)* Më falni, zotërinj por siç e shihni... nuk është e lehtë të jesh prift. Për çka folëm këtu, kyçin gojës, morët vesh? *(Shkon në qelë.)*

SIMONI — Paska lindur bukuroshja...

PJETRI — Ka bërë djalë. Po lëre atë. E kemi në dorë — thotë, po ç'të presim, kur t'na ikë!

SIMONI — Heh çdo të ishte gjë e bukur sikur ta kapnim ne këtë ushtarin e vërtetë.

PJETRI — Sinjor Galoti do të na përqafonte dhe do të na mbushte xhepat me para.

SIMONI — Si të bëjmë që ta fusim në dorë? *(Nusha përpigjet të marrë vesh ndonjë fjalë, pa u vënë re, por duket se ka vështirësi.)*

PJETRI — Unë po zihem me të. Gjoja po zihem. Po i bëj një të përmbledhur: frrrap! Ti rri gati e lidhe.

SIMONI — Gjë e bukur është ta çojmë të lidhur! Ku ka litar?

PJETRI — Ec e merre te lopa, në ahur.

(Simoni shkon për të marrë litarin. Kalon Tefa.)

Afrohu pak, o Tefë. Kam diçka për të të thënë.

TEFA — Ja, sa ta çoj këtë shportë lart.

(Kthehet Simoni me një copë litar në dorë.)

SIMONI — Mos është i shkurtër? Ih, paska qenë i ndotur!

PJETRI — Fshihe e rri gati. Po vjen.

(Kthehet Tefa. Nusha tani diçka ka marrë me mend e duket që është bërë edhe më kureshtare.)

TEFA — Ç'ke, o Pjetër?

PJETRI — E di si është puna, Tefë. Unë mund tërë katundin. Mirëpo ky, Simoni, me të të parë ty me kovat e ujit, më tha: «Hë, shërbëtorin e priftit e mund dot?»

SIMONI — Jo, mos i dredho fjalët. Unë të thashë se shërbëtori i dom Zefit të hedh me këmbë përpjetë.

PJETRI — Po, tamam ashtu the. E provojmë?

TEFA — Më rrëzon, më rrëzon, Pjetër. *(Do të largohet.)*

SIMONI — *(I zë rrugën.)* Tefë, aman bre, mos i bëj bisht. Kam vënë bast me dhjetë napolona.

TEFA — Kam punë.

PJETRI — E sheh? Nuk ia mban. Më jep dhjetë napolonat, Simon.

SIMONI — Thyeja hundët, or Tefë, aman!

TEFA — Mirë atëherë. Meqë po ngul këmbë kaq shumë...

- PJETRI — Fillojmë? (*Kapen.*)
- SIMONI — Jepi, Tefë, jepi! (*Ka nxjerrë litarin dhe sillet andej-këndej që ta lidhë. Po befas ndodh e kundërta e asaj që prisnin të dy miqtë. Pjetri she mbet përdhe sa gjatë gjerë.*)
- NUSHA — (*Duke kuptuar diçka.*) Të lumtë, Tefë!
- PJETRI — (*I shtrirë.*) Lidhe, lidhe!
- TEFA — (*Me dyshim.*) Ç'e ke atë konop, Simon?
- SIMONI — Ja, për atë. E dija që do ta rrëzosh. Hihihihiii! Desha ta lidhja qenin, se kisha frikë mos më ikte pa paguar paratë. Por, me sa shoh, nuk është fare nevoja ta lidhim, sepse nuk është i zoti të ngrihet. (*E hedh litarin.*)
- TEFA — Mos e flak ashtu, se është litari i lopës. (*E merr e largohet.*)
- PJETRI — Më jep dorën të ngrihem, Simon. Ooo! Kam rënë me kurriz mbi një gur. Më vjen sikur më është thyer diçka. Mos qesh ti, Nushë. Pse, për të qeshur është?
- NUSHA — Si të mos qesh! Kush do t'i bëjë varrin tjetrit, bie vetë brenda. (*Largohet nga dritarja. Pjetri ngrihet e fërkon kurrizin.*)
- SIMONI — Duhet lajmëruar kuestura, sa nuk na ka ikur zogu nga dora. Merr biçikletën time!
- PJETRI — Shkojmë bashkë.
- SIMONI — Unë po rri që ta ruaj.
- PJETRI — Oh, ç'roje e fortë! Rri unë.
- SIMONI — Mirë, shkojmë të dy. (*Dalin.*)
(*Vjen Luca. Nusha del nga qela.*)
- LUCA — Aty është ai?
- NUSHA — Ja, po vjen. (*Del Tefa.*)
- LUCA — Mori fund edhe kjo lodër, Tefë. Pas pak, vij të të marr. Tek ura e Bunës na pret një karrocë.
- TEFA — (*E përqafton.*) Falemnderit, Lucë! Erdhe ta-

mam në kohë, sepse sot dom Zefit i dukej dyshimi në fytyrë, si njollë e zezë.

NUSHA — Mos humbisni asnjë minutë.

TEFA — Ç'flet kështu?

NUSHA — Simoni dhe Pjetri shkuan të lajmërojnë policinë. Unë dyshova që në fillim, po nuk uà merrja vesh mirë fjalët. Edhe mundja ishte një kurth, Tefë.

TEFA — Domethënë unë nuk dyshova kot. Ika.

LUCA — Prit! Puna është ngatërruar. Duhet menduar mirë si të largohesh sepse mund të të kapin rrugës.

NUSHA — Fshihu në stallë. Pritmë mua aty.

TEFA — Ç'do të bësh?

NUSHA — Do shohësh. Jam grua dhe nuk e kam kokën kot mbi qafë.

(Nusha shkon lart. Tefa futet në ahur. Vjen zoti Gjon dhe pas tij Loroja me valixhe.)

GJONI — Loro, shko te kaloshina, ç'më vjen pas si konkë!

LOROJA — Vetë më the, zotëri.

GJONI — Plasi sytë pak! Nuk sheh si janë grumbulluar fëmijët?

LOROJA — Nuk i bëjnë gjë.

GJONI — Nuk i bëjnë gjë, thua! Po të trembin kalin, mor budalla, e kali hop me këmbë përpjetë! Shtyp ndonjë nga ata klyshët e ruajna zot, i mbushet mendja dhe shkon e mbytet në liqen! Kjo është më e keqja!

LOROJA — Sëkëlldisesh kot, zotëri, ai nuk është prej atyre kuajve. Është plak, e plaku, siç e di dhe zotrote, nuk mbytet kurrë me vetëdashje.

GJONI — Do të më shesësh mend, more plep i kalbur!

(Vjen nga rruga murgesha.)

LOROJA — (I del përpara.) Lule...

GJONI — Shko te kaloshina e mos më detyro të të...
Uf, ç'vapë! Edhe kur flas djersij, e marrtë e mira
këtë dhjamin tim. Ej, Loro, ec më bëj fresk! (Ulet
në karrige.)

LOROJA — Nuk mund të ndahem më dysh, zotëri. The
të shkoj te kaloshina, atje do të vete.

GJONI — Qen!

LOROJA — (Murgeshës.) Eja atje e bisedojmë, Lulë.

MURGESHA — Na shikon kali!... (Shkon nga kisha.
Edhe Lorja del.)

(Vjen Luca, po kur sheh Gjonin do të kthe-
het.)

GJONI — Ec, ec këtu ti pelivan, mos ik, ej, ec të them!

LUCA — Jam për ngut, zotëri.

GJONI — Nguti i tyt eti! Ku i ke veglat e rrojës?

LUCA — Në shtëpi.

GJONI — Shko e merri. Pa fjalë! Thyej qafën shpejt e
eja më hiq një brisk.

LUCA — Ika. (Vrapon nga porta. Ndeshet me Loron.
I fut krahun dhe diçka bisedojnë nën zë. Dalin
bashkë.)

GJONI — Ej, ti, Lucë! Rend, ore, rend, e mos u merr
me atë torollak. Me ty e kam, more ti shurdh! Uf,
ç'vapë! Edhe ky bataçiu me veladon nuk po duket
gjëkund. Do të ngjitem lart, oh! Po shkrihem fare
nga djersët. (Vjen nga qela Nusha e pas tij Tefa i
veshur prift. Përpiqen të ikin pa u parë, po Gjoni
i shikon, kërcen dhe e kap për krahu Tefën.) He,
s'deshe të më thuash as mirë se erdhe, a? S'do
mend, e do xhaxhanë tënd, si kripën në sy, pran-
daj deshe të më çoje te të shumtët kur më the se

gjoja më ka plasur tëmthi. Po unë, ja, jam si div, për inatin tënd; dhe do të rri këtu, do të vazhdoj banjat, do të ha e do të pi si të kem qejf.

NUSHA — (*E ndihmon Tefën të shkëputet nga ai.*) Mos i bjer në qafë, zotëri. (*Te porta duket Luca. E merr Tefën pa u parë dhe zhduken.*) Ka vdekur një njeri e po shkon të kryej detyrën si prift...

GJONI — Qeni, s'e ktheu kokën as të më shihte. Oi, shiko, shiko, hipi në kaloshinë. Loro, Loro ore të marrtë dreqi, ndalu! Ej, ndaleni, bre, ndaleni atë maskara! Si duket ia ka lyer rrotën dom Zefi, prandaj ka aq zell, qeni! Kaaapeniiii! (*Del duke rëndur si mundet e duke thirrur: «Kapeni!» (Vjen Luca.)*)

NUSHA — Po ti, nuk shkove me Tefën?

LUCA — Unë jam si puna e mjaltit që mbledh miza, Nushë. Dua të them se më njohin shumë e prandaj, mund të ngjall dyshime. Do të thoshin njerëzit: «Oh, shiko, shiko, Luca me dom Zefin!»

NUSHA — Po Loroja e di ku duhet ta çojë?

LUCA — Tefën e presin njerëz te ura e Bunës. (*Kthehet Gjoni.*) Uhuhuhu, u kthye ky lugati. Ika.

GJONI — (*Lëshohet mbi karrige.*) Uf, mbarova... (*Befas.*) Më duket se pashë Lucën, ç'u bë?

NUSHA — Shkoi të marrë veglat e rrojes.

GJONI — Hëh, qeni! (*Heq xhaketën.*) E mbaj kot këtë mbulesë... Bile po heq edhe pant... Apo jo, atje më mirë. Nushë, merre këtë çantë.

NUSHA — Ku ta çoj, zotëri? (*E merr.*)

GJONI — Atje në breg. Nuk jam i zoti të ngjitem lart për t'u zhveshur. Me rroba banje ndihet i nxehti më pak, me siguri. Hë de, luaj Nushë. Këtëj moj, ç'je hutuar. Edhe dëgjo, mos vono shumë e më sill

diçka që të përtypem duke bërë banjë, hë? (*Dalin. Pas pak hyjnë me vrull në oborr një oficer dhe karabinierë.*)

OFICERI — Presto, rrethoni kishën dhe qelën.

NJË GRADUAT — Sinjor, si! (*Shpërndan policët dhe karabinierët. Te dera duken Simoni dhe Pjetri.*)

SIMONI — Paskan ardhur!

PJETRI — E sheh sa shpejt? Salute sinjor!

OFICERI — Kush jeni ju?

SIMONI — Unë jam kryeplaku, ndërsa ky është anëtari i kryepleqësisë.

PJETRI — Unë ju lajmërova me telefon, sinjor.

OFICERI — Shumë gabim. Telefoni nuk është për këto punë.

PJETRI — M'u shpua biçikleta në rrugë, sinjor.

SIMONI — Thuaj se je dembel, Pjetër. Këmbët nuk i kishë me vete?

PJETRI — Pse nuk shkove ti i shkathëti?

OFICERI — Lërini fjalët! Thirrmani shpejt atë...

SIMONI — Tefë, o Tefë!

PJETRI — Tefë djalli!

OFICERI — Nuk po përgjigjet. Ngjitemi lart e shohim. Prit! Si mendoni, mos është i armatosur?

SIMONI — Unë them jo.

PJETRI — Unë them po.

OFICERI — (*I vështron me vrazhdësi.*) Prini përpara!

SIMONI — Oh, ç'thua ashtu, sinjor, urdhëroni, urdhëroni!

PJETRI — Duket s'ia mban, prandaj bën naze si ato konkat bishtdredhura. Prij unë, sinjor. (*Niset.*) Prit! Nuk do të ishte keq sikur të prijë ti Simon, meqë je kryeplaku.

OFICERI — Hëh, budallenj! (*Futet në qelë i zemëruar. Pas tij shkojnë Simoni e Pjetri.*)

Errësohet për pak. Kur ndizen dritat, gjende-
mi në korridorin e qelës. Oficeri troket në një
derë.

OFICERI — Djema! Kini mendjen! (Troket përsëri.)

SIMONI — Mos, mos, aty është dhoma e dom Zefit.

Duhet të jetë duke bërë pushimin e drekës.

OFICERI — Silencio! (Troket me forcë.)

(Hapet dera dhe duket në prag, ashtu si ka
genë duke fjetur, dom Zefi.)

DOM ZEFI — Oh, erdhët!

OFICERI — Duart lart!

DOM ZEFI — Mos bëni shaka, sinjore.

OFICERI — Përpara!

DOM ZEFI — Sinjore, jam prifti.

SIMONI — Famulltari ynë, sinjor.

PJETRI — Dora vetë.

OFICERI — E kujt t'u besoj, atyre dy fshatarëve që
shoqëronin famulltarin në kaloshinë, apo ju? Ai
dukej më shumë prift se ky. Madje ai më tregoi
edhe derën ku duhej të trokisja për ta zënë si mi
këtë maskara! (Policëve.) Kontrolloni dhomën!

SIMONI — E megjithatë prifti është ky.

DOM ZEFI — Këtu ka një keqkuptim.

OFICERI — E sqarojnë në kuesturë.

PJETRI — Kushedi ç'prift keni takuar ju.

OFICERI — Prangat!

DOM ZEFI — Së paku të vishem.

OFICERI — Mos luaj.

(Një polic sjell Agetinën.)

AGETINA — Ç'doni nga unë, sinjore?

OFICERI — Përse keni ardhur këtu?

AGETINA — Jam kushërira e dom Zefit...

OFICERI — (*Disi i habitur.*) Dhe flini bashkë?!

DOM ZEFI — Sinjore, nuk keni punë me këtë. Mua më vutë prangat! Prandaj nisemi.

(*Vjen Galoti.*)

GALOTI — Hë, ku është?

OFICERI — Ja, sinjor maxhiore.¹⁾

GALOTI — Ky është dom Zefi, famulltari, bestie²⁾!
Zgjidheni!

OFICERI — E pamundur, është tamam ky... (*Tregon me sy Agetinën.*)

DOM ZEFI — Nuk arsyetonte fare, ky oficeri, sinjor Galoti.

OFICERI — Po ai tjetri kush ishte?

GALOTI — Cili tjetër?

OFICERI — Ai që ishte në kaloshinë.

SIMONI — E kush mund të ishte tjetër përveç Tefës.

PJETRI — Shërbëtori i priftit.

OFICERI — Ai tha se ishte famulltari, sinjor maxhiore, e ky me këtë veshje dhe me këtë femrën nuk ta mbush mendjen që...

GALOTI — Porka madona! Ju ka kaluar nën hundë... E kam thënë dhe po ta përsëris Xhuzepe, se ty të mungon nuhatja, si atij zagarit të keq. Të vrapojmë se mos e zëmë pa hyrë në qytet. Presto. (*Dalin me zhurmë. Me të ikin edhe Simoni e Pjetri.*)

AGETINA — (*Pas një heshtjeje.*) Uh, gati më ra pika...

DOM ZEFI — Gjithçka më duket si një ëndërr e keqe... Nushë! Nushë! Edhe ajo paska ikur. S'do mend, s'kishte si qëndronte pas gjithë kësaj që ndodhi. (*Duke zënë fytyrën me duar.*) Oh, ç'lojë të bukur më luajti ai shërbëtori!

1) zoti major,

2) kafshë,

ZËRI I GJONIT — Nushë moj, plaç! Sillmë diçka për të
ngrënë, të marrtë dreqi farën!

AGETINA — Zoti Gjon!

DOM ZEFI — Edhe ky qe mangut! Ç'po më vjen koka
vërdallë... prej shërbëtorit. Si s'e kapa, si s'e kapa...
(Zë kokën me duar.)

Perdja